

Shtojca 15

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

Pogradec, më 14.12.2020

Për: Bashkimin e Operatoreve Ekonomike:

1. **REJ SHPK**, me adrese sipas QKB-së "TIRANE Zogu i Zi, Qatar Center, kati 2", me numër NIPT: J93711608Q, perfaqesuar nga administratori z. Luan Kapri.

&

2. "ADA-CO" SHPK, me adresë sipas QKB-së "POGRADEC ZONA INDUSTRIALE", me numër NIPT: K64112603J, perfaqesuar nga administratori znj. Selvi Latifllari.

Bashkimi i Operatoreve te mesiperm, me prokure perfaqesohet nga O.E ADA-CO" SHPK, perfaqesuar nga administratori znj. Selvi Latifllari.

Procedura e prokurimit: "Kërkesë për Propozime" - "Punë" - "Prokurim Elektronik".

Numri i referencës së procedurës: REF-70416-09-01-2020

Përshkrim i shkurtër i kontratës: Objekti "Ndertim mure rrethues dhe sistemim te oborreve ne institucionet shkollore", 7 410 185,84 (Shtatë milion e katërqind e dhjetë mijë e njëqind e tetëdhjetë e pesë presje tetëdhjetë e katër) lekë.

Publikime të mëparshme: Buletini i Njoftimeve Publike Nr. 66 datë 08 Shtator 2020.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

Çmimi më i ulët

Oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë:

REJ SHPK

NIPT: J93711608Q

&

ADA CO SHPK

NIPT: K64112603J

Vlera e ofertes pa TVSH: 6 255 343 (Gjashte milion e dyqind e pesedhjetë e pesë mijë e treqind e dyzete e tre) Lekë pa TVSH.

2. C O L O M B O SHPK

NIPT: J82916489E

Vlera e ofertes pa TVSH: 5 883 753 (Pesë milion e teteqind e tetëdhjetë e tre mijë e shtateqind e pesëdhjetë e tre) lekë pa TVSH.

3. INFINIT SHPK

NIPT: J74304623M

Vlera e ofertes pa TVSH: 5 717 515 (Pesë milion e shtateqind e shtatëmbëdhjetë mijë e pesëqind e pesëmbëdhjetë) lekë pa TVSH.

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. C O L O M B O SHPK

NIPT: J82916489E

2. INFINIT SHPK

NIPT: J74304623M

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

A. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur në SPE, nga operatori ekonomik **INFINIT SHPK me numër NIPT: J74304623M**, rezultoi se kishte mangësi të cilat janë në kundërshtim me Dokumentat Standarte të Tenderit dhe aktet ligjore dhe nënligjore, të cilat po i parashtrajmë si më poshtë:

1. Të gjitha shtojcat janë plotësuar në kundërshtim me rekomandimet e Agjencisë së Prokurimit Publik dhe me aktet përkatëse, të detajuar si më poshtë:

- Shtojca 1/1, është plotësuar gabim pasi tek pika 6 është selektuar pika "b", kur ne rastin konkret O.E INFINIT SHPK, ka paraqitur ofertën si operator ekonomik i vetëm dhe jo bashkim operatorësh. Gjithashtu data e shtojcës është 27.08.2020, dhe jo data e hapjes së ofertave 21.09.2020.

- Shtojcat 5 dhe 6 mbajnë datat e dorëzimit 27.08.2020, dhe jo data e hapjes së ofertave 21.09.2020.

- Shtojca 8 NUK është plotësuar me emrat e personave në cilësinë e *anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik* dhe gjithashtu mban datën e dorëzimit 27.08.2020, dhe jo data e hapjes së ofertave 21.09.2020.

Per sa me siper, të gjitha shtojcat e paraqitura nga O.E INFINIT SHPK, nuk perputhen me shtojcat e DST dhe jane plotesuar gabim referuar parimeve te DST, ku kerkohej qe shtojcat te plotesohen me daten e hapjes se ofertave, dhe konkretisht kriteret e pergjithshme, duhet te plotesohen **me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 4., nderkohe qe shtojca 4 e paraqitur ne SPE nga ofertuesi eshte "LISTA E INFORMACIONIT KONFIDENCIAL"**.

Në dokumentat e tenderit, Seksioni II Udhëzime për operatorët ekonomikë, Seksioni 1 Hartimi i ofertës, në pikën 1.1. është përcaktuar se: ***"Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këto DT. Ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto DT do të refuzohen si të papranueshme"***.

2. Nga verifikimi i dokumentacioni te ngarkuar ne SPE, rezulton se O.E INFINIT SHPK nuk ka paraqitur deklarate (nga Administratori i shoqërisë) Drejtuesin/(t) Teknik të punimeve në objekt, shoqeruar me dokumentacionin e meposhtem:

- Kontrate pune e vlefshme.
- Diplome.

Mungesa e deklarates dhe dokumentacionit perkates perben shkas per skualifikim pasi nuk ploteson kriterin 2.3.3 te DST, i ndryshuar.

3. Nga verifikimi i dokumentacioni te ngarkuar ne SPE, rezulton se O.E INFINIT SHPK nuk ka paraqitur deklaratat te kerkuara ne pikat c, d,e të kriterit 2.3.9 të DST, per sa më poshtë:

c) Operatori ekonomik ofertues duhet te deklaroje se mjetet e paraqitura ne oferte nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe do te jene ne dispozicion te zbatimit te punimeve ne objektin qe tenderohet.

d) Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese ku te deklarohet dhe vendndodhja e mjeteve ne pronesi ose me qera me qellim verifikimi ne çdo kohe prej Autoritetit Kontraktor.

e) Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruar sipas shtojcës. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese).

4. Me anë të vertetimit per shlyerje detyrimesh Nr. T02774189, datë, 28.08.2020, O.E INFINIT SHPK nuk deshmon qe ka shlyer detyrimet tatimore deri me date 21.09.2020, date e hapjes se ofertave.

Përsa më sipër, në zbatim të, nenit 45 dhe nenit 46 "Kualifikimi i ofertuesve" të Ligjit Nr.9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, dhe akteve nenligjore operatori ekonomik INFINIT SHPK me numër NIPT: J74304623M, SKUALIFIKOHET.

B. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur në SPE, nga operatori ekonomik **C O L O M B O SHPK, NIPT: J82916489E**, rezultoi se kishte mangesi të cilat janë në kundërshtim me Dokumentat Standarte të Tenderit dhe aktet ligjore dhe nënligjore, të cilat po i parashtrijmë si më poshtë:

1. Nga verifikimi i dokumentacionit të ngarkuar në SPE, rezulton se **C O L O M B O SHPK** nuk ka paraqitur certifikatën ISO PAS 99-2012 (Sistemi i Integruar i menaxhimit) ose ekuivalente me to, leshuar nga institucionet zyrtare të akredituar për këtë qëllim, sipas kërkesave të kriterit 2.3.7 të DST.

2. Shtojcat e ngarkuara në SPE nga ofertuesi, 4 dhe 4/1 janë plotësuar në kundërshtim me rekomandimet e Agjencisë së Prokurimit Publik dhe me aktet përkatëse, të detajuar si më poshtë:

- Shtojca 4 nuk përputhet me shtojcat e DST dhe janë plotësuar gabim referuar parimeve të DST, ku kërkohej që shtojcat të plotësohen me datën e hapjes së ofertave, dhe konkretisht kriteret e përgjithshme, duhet të plotësohen **me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 4, nderkohe që shtojca 4 e paraqitur në SPE nga ofertuesi është "LISTA E INFORMACIONIT KONFIDENCIAL"**.

Gjithashtu shtojca 4/1 e DST, "**DEKLARATË MBI GARANTIMIN E ZBATUESHMËRISË SË DISPOZITAVE LIGJORE NË MARRËDHËNIET E PUNËS**", korrespondon me shtojcën 8 të ngarkuar nga ofertuesi.

Te gjitha këto gabime nga ana e ofertuesit, vijnë në kundërshtim me kriterin e DST 2.1.2 Plotësimi i të gjithë shtojcave sipas DST dhe me dokumentat e tenderit, Seksioni II Udhëzime për operatorët ekonomikë, Seksioni 1 Hartimi i ofertës, në pikën 1.1. është përcaktuar se: "*Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këto DT. Ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto DT do të refuzohen si të papranueshme*".

3. Në përmbushje të kriterit 2.3.8 të DST, ofertuesi ka dorëzuar Kontrate shitblerje date 10.12.2019, me KURUM INTERNATIONAL sh.a , me objekt furnizimin me **hekur betoni**.

Për sa me sipër, dhe referuar dokumentacionit të paraqitur në SPE, rezulton se ofertuesi nuk plotëson kriterin 2.3.8 të DST, pasi kontrata e furnizimit nuk ka për objekt furnizimin me materialin "**rrjete teli ekzagonal**" dhe gjithashtu mungon certifikata e cilësie për materialin "**rrjete teli ekzagonal**".

Perfundimisht nga ana e ofertuesit **C O L O M B O SHPK** NUK plotësohet kriteri **2.3.8 i DST, ku kërkohej që:** Ofertuesit duhet të paraqesin kontratë furnizimi shoqëruar me certifikatë cilësie për materialin "**rrjete teli ekzagonal**", që do të përdoret për këtë objekt sipas specifikimeve teknike të përdorura në këtë prokurim.

4. Ofertuesi nuk deshmon se ka ne pronesi, me qera ose me kontrate furnzimi, 1 "Nyje prodhimi inertesh e pajisur me Leje Mjedisi te Vlefshme", pasi nga dokumentacioni i paraqitur rezulton se qeradhenesi ka ne pronesi impiant inertesh dhe betoni dhe impiant per prodhimin e asfaltobetonit, pajisur me "Leje mjedisore per shfrytezimin e gurit gelqeror ne karrierë".

Pra, kemi dy mangesi, pasi e para nga dokumentacioni nuk deshmohet se ofertuesi posedon nyje **prodhimi dhe e dyta leja mjedisore eshte per shfrytezim dhe jo per prodhim.**

Përsa më sipër, në zbatim të, nenit 45 dhe nenit 46 "Kualifikimi i ofertuesve" të Ligjit Nr.9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, dhe akteve nenligjore operatori ekonomik C O L O M B O SHPK, NIPT: J82916489E, SKUALIFIKOHET.

* * *

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 24.09.2020.

Ankesa pranë Autoritetit Kontraktor: PO

Ka marrë përgjigje me shkresen Nr. 968/6, datë 09.10.2020, ku me Vendimin të K.SH.A, Nr.6, date 09.10.2020, i eshte refuzuar ankesa.

Ankesa pranë Komisionit të Prokurimit Publik: PO

Komisioni i Prokurimit Publik me VENDIM K.P.P. 557/2020, ka vendosur *"Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik "Infinit" sh.p.k" dhe "Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshme të procedurës së prokurimit"*.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë perfaqesuesin e B.O.E, "ADA-CO" SHPK, me adresë sipas QKB-së "POGRADEC ZONA INDUSTRIALE", me numër NIPT: K64112603J, perfaqesuar nga administratori znj. Selvi Latifllari, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme pa TVSH prej 6 255 343 (Gjashte milion e dyqind e pesedhete e pese mije e treqind e dyzete e tre) Lekë , është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë *Ndermarrjes se Mirembajtjes se Infrastrukturave dhe Puneve Publike, Kati IV, Bashkia Pogradec*, sigurimin e kontratës dhe dokumentacionin e ngarkuar ne SPE origjinal dhe/ose fotokopje te noterizuar, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda _5 (Pesë) ditëve nga dita e marrjes së këtij njoftimi në SPE.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, procedura e prokurimit do të anulohet për mungesë konkurrence, siç parashikohet në Ligjin nr.9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 24.09.2020.

Ankesa pranë Autoritetit Kontraktor: PO

Ka marrë përgjigje me shkresën Nr. 968/6, datë 09.10.2020, ku me Vendimin të K.SH.A, Nr.6, date 09.10.2020, i është refuzuar ankesa.

Ankesa pranë Komisionit të Prokurimit Publik: PO

Komisioni i Prokurimit Publik me VENDIM K.P.P. 557/2020, ka vendosur "*Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik "Infinit" sh.p.k" dhe "Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshme të procedurës së prokurimit".*

**[TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR]
ENTON BERBERI**